



Në bazë të nenit 5, paragrafi 11 të Vendimit mbi organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale të Komunës së Tuzit („Fleta zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale“, nr. 022/23 prej më 05.05.2023, 024/23 prej më 18.05.2023, 029/24 prej më 06.06.2024, 032/24 prej më 25.06.2024, 012/25 prej më 20.03.2025), Sekretariati për vetëqeverisje lokale shpall

FTESË PUBLIKE
PËR DHËNIEN NË PËRDORIM PA PAGESË TË SHTËPIZAVE
GJATË “PAZARIT TË VERËS” 2025

Në kuadër të manifestimit “Vera në Malësi”, Komuna e Tuzit organizon “Pazarin e dytë të verës”, i cili do të mbahet **nga data 5 deri më 20 gusht 2025**, në sheshin “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” në Tuz. Ky organizim ka për qëllim të nxisë zhvillimin ekonomik dhe turistik, duke kontribuar në afirmimin dhe vlerësimin e potencialit kulturor, traditës dhe vlerave kulturore të Komunës së Tuzit.

Me këtë rast, ftojme të gjithë të interesuarit me vendbanim në territorin e komunës së Tuzit: sipërmarrës, artizanë, kompani ekonomike, persona që merren me veprimtari të ndryshme zejtarie (punime dore), prodhime bujqësore sezonale, pije dhe ushqime, persona të angazhuar në ofertën dhe prodhimin gastronomik, të aplikojnë për pjesëmarrje në “Pazarin e dytë të verës” dhe të përfitojnë nga përdorimi pa pagesë i shtëpizave gjatë periudhës së caktuar.

Aplikimi bëhet përmes plotësimit të formularit përkatës, i cili mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e Komunës së Tuzit ose të merret fizikisht në arkivin e Komunës.

Afati për dorëzimin e aplikimeve është nga data **2 korrik deri më 18 korrik 2025**, deri në orën 16:00, në një nga mënyrat e mëposhtme:

- në adresën elektronike: tuzi@tuzi.org.me;
- përmes postës në adresën: Komuna e Tuzit, rr. Tuz nr. 1, nr. 44;
- ose dorazi, në arkivin e Komunës së Tuzit, me shënimin: “Për pjesëmarrje në Pazarin e verës”.

SEKRETARE
MARINA UJKAJ

